



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

VENDIM

Nr. 5, datë 16.10.2017

PËR  
MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR,  
BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të neneve 7, 20 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Bashkisë Shkodër, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 19, datë 24.03.2017 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve-Strategjike të Zhvillimit të Bashkisë Shkodër” si dhe Vendimit Nr. 27, datë 20.04.2014 “Për miratimin e Planit të Zhvillimit të Territorit dhe Rregulloren e zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
  - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
  - b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
  - c) Rregullorja e Planit;
  - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
  - e) Materiali hartografik:
    - i. Vizioni strategjik;
    - ii. Ndarja e territorit në 5 sisteme;
    - iii. Ndarja e territorit në njësi;
    - iv. Përdorimi i propozuar i tokës sipas 14 kategorive bazë;
    - v. Infrastruktura e transportit;
    - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
2. Në Zonat e Rëndësisë Kombëtare brenda territorit administrativ të Bashkisë Shkodër, shpallur si të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit apo me vendime të veçanta, autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara është Këshilli Kombëtar i Territorit.

- SHILLI M
3. Në Zonat e përcaktuara si të Rëndësisë Kombëtare dhe për Objektet e Rëndësisë Kombëtare, përfshirë edhe ato që ngrihen në pronat shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore, autoriteti përgjegjës për miratimin e Lejeve të Zhvillimit dhe Ndërtimit, është Këshilli Kombëtar i Territorit.
  4. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Shkodër duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.
  5. Ngarkohet Bashkia Shkodër për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
  6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen studimet urbanistike/dokumentet e planifikimit të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Shkodër përfshirë, por pa u kufizuar në to, si më poshtë:
    - Vendim Nr. 2, datë 04.02.1994 i KRRTRSH-së “Për planin rregullues të qytetit të Shkodrës”;
    - Vendim Nr. 9, datë 10.06.1994 i KRRTRSH-së “Për vijen kufizuese mbrojtëse të liqenit të Shkodrës”;
    - Vendim Nr. 4, datë 19.02.2003 i KRRTRSH-së “Për detyrën e projektimit për studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Shkodrës dhe vijen kufizuese të kësaj qendre”;
    - Vendim Nr. 4, datë 07.05.2005 i KRRTRSH-së “Për rishikimin e zonimit funksional të Planit Rregullues të qytetit të Shkodrës”;
    - Vendim Nr. 14, datë 04.07.2013, i KKT-së “Instrumenti i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Shkodër”;
    - Vendim Nr. 31, datë 23.08.1994, i KRRTRSH-së “Mbi studimin urbanistik të zonës turistike të Velipojës”;
    - Vendim Nr. 1, datë 18.06.2003 i KRRTRSH-së “Për studimin urbanistik për zhvillimin turistik dhe mbrojtjen e zonës turistike të Velipojës”;
    - Vendim Nr. 12, datë 01.06.2012 i KKT-së “Detyra e Projektimit për zgjerimin e Masterplanit të Velipojës dhe studim urbanistik i zhvillimit turistik të zonës bregdetare Pulaj, shtesë e ristudimit urbanistik të zhvillimit turistik dhe i mbrojtjes së bregut të detit në Velipojë, Komuna Velipojë”.
  7. Planet e detajuara vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
  8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**DAMIAN GJIKNURI**

**MINISTER I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

